



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Thirrje për ofertë për shërbime printimi

Hyrje

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është një organizatë jofitimprurëse, jo-qeveritare me mision për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, besimin fetar, moshën, nivelin e arsimit, orientimin seksual dhe aftësinë.

Si një rrjet me 139 anëtare, organizata të udhëhequra nga gratë e grupeve etnike të ndryshme të shpërndara në të gjithë Kosovën, këto grupe realizojnë iniciativë të rëndësishme për avancimin e të drejtave të grave, sipas qëllimeve të vendosura në Strategjinë e RrGK-së për periudhën 2023-2026. RrGK ka një Strategji të Marrëdhënieve me Publikun, dhe markimi dhe imazhi ynë janë të rëndësishme për ne. Në të ardhmen, RrGK gjithashtu planifikon të përdorë uebfaqen e saj për donacione online në lidhje me produkte që përfshijnë printimin (shtypje) (p.sh., filxhanë, bluzë, etj.), për të cilat RrGK ka nevojë të bashkëpunojë me një kompani shtypi.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të kërkojë oferta nga kompani profesionale të printimit për të krijuar një kontratë kornizë për shërbime printimi për RrGK-në për një periudhë trevjeçare. Furnizuesi i përzgjedhur do të pritët të ofrojë shërbime printimi me cilësi të lartë në kohë, duke respektuar objektivat e qëndrueshmërisë së RrGK-së në lidhje me printim miqësor ndaj mjedisit. Kontrata do të jepet përmes një procesi tenderimi konkurrues.

Kualifikimet

Kompania e përzgjedhur duhet të plotësojë këto kualifikime:

- **Përvoja:** Të paktën dy vjet përvojë profesionale në ofrimin e shërbimeve të shtypit me cilësi të lartë.
- **Aftësia për Shtypje Miqësore me Mjedisin:** Aftësia për të përdorur metoda shtypjeje miqësore ndaj mjedisit dhe materiale të qëndrueshme që reduktojnë ndikimin në mjedis.

Përgjegjësitë

Kompania e kontraktuar do të pritët të:

- Përgjigjet menjëherë dhe profesionalisht ndaj kërkesave për printim nga RrGK;
- Këshillojë për çdo ndryshim të nevojshëm në formatim dhe dizajn për të siguruar printim me cilësi të lartë;
- Të përdorë, sa herë të jetë e mundur, printim miqësor ndaj mjedisit, duke përfshirë materiale të ricikluar me ndikim të ulët në mjedis dhe bojëra të ricikluara;
- Minimizohet përdorimi i plastikës dhe materialeve të tjera jo-biodegradueshme.

Aplikuesit duhet të tregojnë në ofertën e tyre nëse mund të ofrojnë shërbime dërgesash **a)** në zyrën e RrGK; dhe **b)** drejtpërdrejt te klientët që bëjnë porosi përmes faqes së internetit të RrGK. Nëse dërgesa te klientët nuk është e mundur, ju lutem specifikoni këtë në ofertë. Nëse shërbime të tilla janë të disponueshme, aplikuesit duhet të tregojnë në ofertën e tyre nëse ekzistojnë kosto shtesë dhe si do të llogariten kostot e dërgesës. Dërgesat duhet të jenë të shpejta, efikase në kosto dhe miqësore ndaj mjedisit sa herë të jetë e mundur.

Vlerësimi i Çmimeve

Si pjesë e Propozimit Financiar, aplikuesit kërkohen të ofrojnë çmimet e tyre aktuale për artikujt e mëposhtëm **pa TVSH, në tabelën e mëposhtme**. Mund të shtohen rreshta të tjerë nëse aplikuesi propozon të ofrojë produkte

të tjera për RrGK-në ose dëshiron të specifikojë më tej kostot e printimit për artikuj të ndryshëm. Të gjitha produktet e parashikuara janë me ngjyra, përveç kur tregohet ndryshe.

Produkti	Çmimi për njësi
Certifikata	
Simbole/Pano/Shenja	
Fletë përmbledhëse/faktesh (A4) Për publikimet A4, lidhje profesionale. A4 duhet të jenë në tri versione, varësisht nga këkesa që bëjmë: printime në të dy anët, me ngjyra ose bardh e zi, me lidhje profesionale ose me palosje.	
Fletë përmbledhëse/faktesh(A5)	
Pamfleta (me palosje)	
Roll-up Banners/Banera	
Filxhanë të Kafesë (e madhe – 200 ml)	
Kartela të Biznesit	
T-Shirt/ Bluzë me mëngë të shkurta	
Bluzë me mëngë të gjata/Duks	
Shishe Uji (70 ml)	
Fletore A5	
Fletore më të Vogla (gjatësia 15 cm dhe gjerësia 10cm)	
Lapsa	
Stilolaps	
Publikime të Binded A4 (kostos për faqe bardh dhe të zezë)	
Certifikata	

Dorëzimi i Ofertave

Ofertat duhet të përmbajnë kërkesat e mëposhtme, së bashku me çdo dokument shtesë që paraqet kualifikimet dhe praktikën e qëndrueshmërisë së kompanisë tuaj. Oferta duhet të përfshijë:

1. Propozim Narrativ, duke përfshirë:

1. Profilin e kompanisë që tregon përvojën përkatëse;
2. Shembuj të punëve të kaluara;
3. Politikat për printim miqësor ndaj mjedisit dhe/ose aftësinë për të ofruar printim miqësor ndaj mjedisit, nëse janë të disponueshme, përfshirë për cilat produkte janë të disponueshme;
4. Metodologjia e propozuar për ofrimin e shërbimeve të dërgesave, nëse shërbime të tilla janë të disponueshme.

2. Propozimi Financiar, duke përdorur tabelën më sipër, përfshirë çdo informacion në lidhje me çmimet e zbritura për porosi më të mëdha për produkte të veçanta dhe metodologjinë e llogaritjes së kostove për dërgesat nëse shërbime të tilla janë të disponueshme.

3. Tre referenca me informacion kontaktues nga klientë të tanishëm ose të mëparshëm, që tregojnë përvojë, profesionalizëm dhe dorëzim në kohë.

Vlerësimi i Ofertave

- Ofertat do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:
- Konkurrueshmëria e Çmimit **40%**
- Përvoja, kualifikimet dhe cilësia e punës **30%**
- Aftësia për të ofruar printim miqësor ndaj mjedisit **20%**
- Metodologjia e propozuar për dërgesa **10%**

Dorëzimi i Ofertave

Ju lutemi dorëzoni dokumentet e kërkuara deri më 26 Mars 2025, në jobs@womensnetwork.org me titull "Oferta për Printim".

